




Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance

Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administraciia Kosovo – Tax Administration of Kosovo



Datë: 01.11.2018

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil Administrata Tatimore e Kosovës shpall:

KONKURS I BRENDSHËM

Titulli i pozitës: *Zyrtar i Lartë Tatimor (1 pozitë)*

Nr. i referencës së pozitës së punës: *BF/740/JP00034159*

Përgjegjësi mbikqyrëse: *Jo*

I raporton: *Drejtorit të Drejtorisë për Marrëdhënie Ndërkombëtare*

Pozita: *Pozitë e karrierës*

Orari i plotë i punës: *Po*

Koeficienti: *8.5, plus shtesa e aplikuesahme*

Vendi i punës: *Drejtoria e Përgjithshme-Prishtinë*

Qëllimi i vendit të punës:

Si pjesë e ekipit për bashkëpunim ndërkombëtar të ATK-së përcjell zbatimin e traktateve të reja të tatimit të dyfishtë; merret me kërkesat e METD dhe mban kontakte me tatimpaguesit, përfaqësuesit e tyre dhe administratat tjera tatimore; vepron si pikë kontakti për dhënie të sqarimeve dhe përgjigjeve për personelin për sa i përket legjislacionit tatimor ndërkombëtar dhe krijon dhe mirëmban librarinë me literaturë të METD-së dhe fushave të ndërlidhura me të.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Zbatimi i marrëveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë (METD) - mbështetja në draftimin e udhëzimeve të nevojshme administrative;
2. Ofrimi i mbështetjes për sa i përket zhvillimit të trajnimeve për stafin lidhur me shmangjen e tatimit të dyfishtë;
3. Mbështetja e zhvillimit të procedurave të brendshme lidhur me këmbimin e informatave tatimore;
4. Koordinimi i aktiviteteve të ndërlidhura me këmbimin e informatave bazuar në Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimeve të Dyfishta (METD) dhe legjislacionin ndërkombëtar;
5. Pikë kontakti për stafin e ATK-së lidhur me interpretimin e legjislacionit tatimor ndërkombëtar;
6. Mirëmban librarinë me literaturë lidhur me marrëveshjet tatimore ndërkombëtare dhe literaturën e fushave të ndërlidhura;
7. Në një fazë të mëvonshme: evidentimi dhe monitorimi i përjashtimeve nga tatimet sipas METD
8. Shqyrtimi i kërkesave për METD (nga tatimpaguesit rezident dhe jo-rezident);
9. Sipas nevojës edhe të përkthetjës dokumente.



Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:

Që të kryej këtë punë me sukses, një individ duhet të ketë:

- Diplomë Universitare në Fakultetin Ekonomik , Juridik apo Biznesit
- Minimum 3 vite përvojë pune profesionale.
- Njohuri të mira të legjislacionit tatimor në Kosovë
- Rekomandohet që të ketë njohuri lidhur me ligjislacionin ndërkombëtar
- Njohuri të thellë profesionale në fushën e legjislacionit dhe akteve ligjore, juridike;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve;
- Të ketë njohuri të gjuhës Angleze;

Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Drejtorinë e Përgjithshme të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila gjendet në adresën: Këndi i rrugëve "Bill Klinton" dhe "Dëshmorët e Kombit" p.n. në Prishtinë ose në web-faqen e Administratës Tatimore të Kosovës: www.atk-ks.org tek rubrika e punësimit.

Aplikacionet e plotësuar së bashku me kopje të dëshmive të kërkuara sipas Shpalljes për rekrutim dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme të ATK-së- në Prishtinë ne Zyrën e Burimeve Njerëzore.

Aplikacionit duhet bashkëngjitur të dhënat biografike për përvojën paraprake dhe të gjitha kopjet e kualifikimeve (diplomave, certifikatave të trajnimeve, dëshmi të njohjes së gjuhëve të huaja dhe përdorimit të kompjuterit).

Vetëm aplikacionet zyrtare të Administratës Tatimore do të pranohen.

Njoftimi i do të jete i hapur për dorëzimin e aplikacioneve 8 dite nga dita e publikimit(01.11.2018 deri me datën 08.11.2018).

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha Komunitetet në Kosovë.

"Komunitet jo- shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejte për përfaqësim të drejte dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Aplikacionet e derguara pas dates se fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Per shkak te numrit te madh te kerkesave te pranuar, vetem kandidatet e perzgjedhur ne listen e ngushte do te kontaktohen.

Per informata shtesë mund te kontaktoni ne numrin e tel. 038/200 34 706 .

